



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
KRYETARI**

Nr. 4467/14 Prot.

Tiranë, më 26.11.2018

**FTESË PËR NEGOCIATË**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediane e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) do të realizojë procedurën për kohë transmetimi në lidhje me fushatën e informimit të publikut me objekt: “Për kohë transmetimi në lidhje me fushatën e informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve analoge në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë-Durrës) dhe vijimin në allotmentet e tjera” me fond limit **39,429,000 (tridhjetëenëntëmilione katërqindënjzetëenëntëmijë) lekë** me TVSH, ndarë në Lote si më poshtë:

**Objekti** Loti I “Transmetimi i spoteve të digjitalizimit”

Me fond limit: **37,525,414 lekë** me TVSH

**Objekti** Loti II “Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit”

Me fond limit: **1,903,586 lekë** me TVSH

**Kushtet specifike të kërkuara Loti I “Transmetimi i spoteve të digjitalizimit” janë si më poshtë:**

**Nevoja e transmetimit të spoteve:**

Kalimi nga transmetimet televizive analoge në ato numerike, i konsideruar si proces prioritar, është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare. Ndryshimi i teknologjisë së transmetimit kërkon gjithashtu informimin e popullsisë mbi procesin në tërësi, veprimet që kërkohen të bëhen, shërbimet e ofruara, disponueshmëria dhe parametrat e teknologjisë së re, bashkëpunimin etj.

E drejta e informimit është e drejtë e sanksionuar në Kushtetutë dhe e trajtuar edhe në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Numerike.

Referuar Strategjisë së miratuar me VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012, informimi, shpjegimi dhe shoqërimi i publikut drejt kalimit të plotë në transmetimet numerike përcaktohet si domosdoshmëri për realizimin me sukses të procesit.

Transmetimi i spoteve në televizione dhe radio, si kombëtare dhe lokale, konsiderohet si një mjet efikas për informimin e publikut. Transmetimi i tyre në fasha orare të ndryshme, i jep mundësinë e informimit teleshikuesve (përfshirë personat me aftësi të kufizuar) që ndjekin transmetimet përmes

teknologjisë analoge, se duhet të pajisen me dekodera digjital tokësor të tipit DVB-T2-Universal ose të jenë të pajisur me aparat televizori që ka të inkorporuar dekoderin e këtij tipi.

## **Përmbajtja.**

### **I. AMA do të transmetojë spotet si më poshtë:**

- A.** Një spot prej 30 sekondash për procesin e digjitalizimit në tërësi; dhe
- B.1** Një spot prej 30 sekondash për procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në allotmentin e Tiranës.
- B.2** Një spot prej 30 sekondash për procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në allotmentin e radhës.

Spoti sipas pikës **A** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare si dhe në subjektet TV dhe Radio Lokale të allotmenteve ku vijojnë transmetimet analoge.

Spoti sipas pikës **B.1** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare dhe lokale të Tiranës deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge në allotmentin e Tiranës (qarqet Tirane- Durrës).

Spoti sipas pikës **B.2** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare dhe lokale të allotmentit të radhës ku do të mbyllet transmetimet analoge.

*Përmbajtja e spoteve dhe grafiku i shpërndarjes së transmetimeve të spoteve sipas kategorive, do të përcaktohen në kushtet e kontratës.*

Me mbylljen e transmetimeve analoge më datë 15 janar 2019, numri i spoteve të televizioneve Lokale Tiranë do të shpërndahet për transmetim në raportin 6/7 në kategorinë TV Kombëtare dhe në raportin 1/7 në kategorinë TV Lokale (që vazhdojnë të ofrojnë shërbime analoge), duke u pasuar me transmetim spoti ku njoftohet mbyllja e transmetimeve në allotmentit e radhës dhe me zgjatje të kohës së transmetimit me 20 ditë përtej periudhës 90 ditore, pasi bazuar në Strategjinë e miratuar me VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012, kemi:

- lekë/spot i transmetuar në TV Lokalë (Tiranë) është në raportin 1:3 me spote të transmetuara në TV Lokalë të tjerë.
- lekë/spote të transmetuara në TV Lokalë (Tiranë) janë në raportin 1,7:1 me spote të transmetuara në TV Kombëtarë.

Me mbylljen e transmetimeve analoge më datë 15 janar 2019, numri i spoteve të radiove lokale Tiranë do të shpërndahet për transmetim në raportin 9.4/10 në kategorinë Radio Kombëtare dhe në raportin 0.6/10 në kategorinë Radio Lokale, duke u pasuar me transmetim spoti ku njoftohet mbyllja e transmetimeve në allotmentit e radhës dhe me zgjatje të kohës së transmetimit me 14 ditë kohë transmetimi përtej periudhës 90 ditore, pasi bazuar në Strategjinë e miratuar me VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012, kemi:

- lekë/spot i transmetuar në Radio Lokalë (Tiranë) është në raportin 1:3 me spote të transmetuara në Radio Lokalë të tjerë.
- lekë/spote të transmetuara në Radio Lokalë (Tiranë) janë në raportin 3,3:1 me spote të transmetuara në Radio Kombëtarë.

**Shpeshtësia (numri i Spoteve) në ditë:**

<b>Kategoritë sipas subjekteve</b>	<b>Spote në ditë</b>	<b>Nr. minimal i spoteve që mbulohe me fondin 37,525,414 lekë me TVSH për një periudhë 90 ditore</b>
Televizionet kombëtare	16	1,441
Radio kombëtare	12	1,076
Televizionet Lokale (Tiranë)	8	717
Televizionet Lokale	10	897
Radio lokale (Tiranë)	10	897
Radio lokale	8	717
<b>Totali</b>		<b>5,745</b>

**Periudha e shfaqjes:** 07:00 – 23:00

**Kushtet specifike të kërkuara Loti II “Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit” janë si më poshtë:**

**Nevoja e transmetimit të njoftimeve:**

Referuar Strategjisë së miratuar me VKM-në, nr. 292, datë 02.05.2012, informimi, shpjegimi dhe shoqërimi i publikut drejt kalimit të plotë në transmetimet numerike përcaktohet si domosdoshmëri për realizimin me sukses të procesit

Transmetimi i njoftimeve në subjektet audio dhe audiovizive, konsiderohet si një mjet efikas për informimin e publikut. Transmetimi i tyre në fasha orare të ndryshme, i jep mundësinë e informimit teleshikuesve (përfshirë personat me aftësi të kufizuar) që ndjekin transmetimet përmes teknologjisë analoge, se duhet të pajisen me dekodera digjital tokësor të tipit DVB-T2- ose të jenë të pajisur me aparat televizori që ka të inkorporuar dekoderin e këtij tipi.

**II. AMA do të transmetojë njoftime me përmbajtje si më poshtë:**

- A.** “Autoriteti i Mediave Audiovizive njofton teleshikuesit që ndjekin transmetime televizive përmes teknologjisë analoge se duhet të pajisen me dekoder digjital tokësor të tipit DVB-T2 - ose të jenë të pajisur me aparat televizori që ka të inkorporuar dekoderin e këtij tipi. Në kushte të tjera, pas përfundimit të procesit të digjitalizimit në zonat ku banoni, nuk do të mund të shihni më transmetime televizive. Për informacione të mëtejshme, na kontaktoni në numrin 04 410 44 55 ose 04 410 44 56”.

**B.1** “Të nderuar banorë të njërive administrative në qarqet Tiranë dhe Durrës, Autoriteti i Mediave Audiovizive ju njofton se në datë 15 Janar 2019 do të mbyllen transmetimet televizive analoge. Me teknologjinë e re digjitale, do të mund të shihni më shumë programe pa pagesë dhe me cilësi më të lartë. Për të parë transmetimet digjitale duhet të pajiseni me

dekoder të tipit DVB-T2. Në të kundërt nuk do të keni më mundësi të shihni transmetime televizive. Për çdo pyetje kontaktoni në numrat call center 04 410 4455 dhe 04 410 44556”.

**B.2** “Të nderuar banorë të njësive administrative në qarkun ..... Autoriteti i Mediave Audiovizive ju njofton se në datë \_\_\_/\_\_\_/ 2019 do të mbyllen transmetimet televizive analoge. Me teknologjinë e re digjitale, do të mund të shihni më shumë programe pa pagesë dhe me cilësi më të lartë. Për të parë transmetimet digjitale duhet të pajiseni me dekoder të tipit DVB-T2. Në të kundërt nuk do të keni më mundësi të shihni transmetime televizive. Për çdo pyetje kontaktoni në numrat call center 04 410 4455 dhe 04 410 44556”.

Njoftimi sipas pikës **A** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare si dhe në subjektet TV dhe Radio Lokale të allotmenteve ku vijojnë transmetimet analoge.

Njoftimi sipas pikës **B.1** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare dhe lokale të Tiranës deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë- Durrës).

Njoftimi sipas pikës **B.2** do të transmetohet nga televizionet dhe radiot kombëtare dhe lokale të allotmentit të radhës ku do të mbyllen transmetimet analoge.

*Grafiku i shpërndarjes së transmetimeve të njoftimeve sipas kategorive dhe plotësimi i përmbajtjes së njoftimit B.2., do të përcaktohen në kushtet e kontratës.*

**Shpeshësia (numri i Njoftimeve) në ditë:**

<b>Kategoritë sipas subjekteve</b>	<b>Nr. minimal i njoftimeve që mbulohen me fondin 1,903,586 lekë me TVSH për secilën kategori, për një periudhë 90 ditore</b>
Televizionet Lokale	531
Radio Kombëtare	3,648
Radio Lokale	398
<b>Totali</b>	<b>4,577</b>

**Periudha e shfaqjes:** 07:00 – 23:00

**Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:**

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) fusha e veprimtarisë së subjektit është objekt i kontratës

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është dënuar për shkelje penale,
- b) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës Nr. 1 (bashkangjitur) Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

3. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Këto kritere (pikat 1,3) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura dhe konfirmuara në autoritetet përkatëse për 2 vitet 2016 dhe 2017.
2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore për 2 vitet e fundit 2016 dhe 2017, e cila të jetë të paktën sa 20% e vlerës për secilin Lot.
3. Deklaratë nga agjencia e specializuar se spotet nuk do të transmetohen në subjektet televizive të cilët vazhdojnë transmetimet analoge në allotmentet ku janë mbyllur këto transmetime.
4. Dëshmi për shërbime të së njëjtës natyrë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit (agjencisë së specializuar).

Si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të depozitohen kontratat e lidhura ose/dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre dhe të jetë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të procedurës. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

### **Kriteret e Vlerësimit për kohë transmetimi janë:**

#### **Loti I “Transmetimi i spotit të digjitalizimit”:**

**Fondi limit 37,525,414 lekë me TVSH**

Kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e organeve të masmedias/agjencive të specializuara, janë:

- a) organi i masmedias/agjencia e specializuar (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e);
- b) çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar;
- c) koha e transmetimit.

**20 pikë -** Agjencia që rezulton me vlerën më të lartë të kontratave të ngjashme. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që vlera e kontratave të ngjashme zë në raport me vlerën e kontratave të agjencisë vlerësuar me 20 pikë.

**80 pikë -** Shoqëria që ofron numrin më të madh të spoteve të transmetuara, për fondin e akorduar në shumën prej **37,525,414 lekë me TVSH**, mbi numrin minimal të kërkuar në tabelën “Transmetimi i spotit të digjitalizimit”.

#### **Loti II “Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit”**

**Fondi limit 1,903,586 lekë me TVSH**

Kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e organeve të masmedias/agjencive të specializuara, janë:

- a) organi i masmedias/agjencia e specializuar (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e);
- b) çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar;
- c) koha e transmetimit.

**20 pikë -** Agjencia që rezulton me vlerën më të lartë të kontratave të ngjashme. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që vlera e kontratave të ngjashme zë në raport me vlerën e kontratave të agjencisë, vlerësuar me 20 pikë.

**80 pikë -** Agjencia që ofron numrin më të madh të njoftimeve të transmetuara, për fondin e akorduar në shumën prej **1,903,586 lekë me TVSH**, mbi numrin minimal të kërkuar në tabelën “Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit”.

**Buxheti:** Buxheti duhet të përfshijë të gjitha detyrimet fiskale që rrjedhin nga ky shërbim.

**Kohëzgjatja e fushatës:** Nga data e lidhjes së kontratës deri në përbushjen e shërbimit të kërkuar.

**Komisioni i ndjekjes së procedurave dhe hartimit të dokumentave vendos që data përfundimtare për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit nga agjencitë e specializuara është data 04.12.2018, ora 12:00, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën origjinale si dhe dokumentacionin e kërkuar më sipër të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit, dhe të shënohet ofertë për kryerjen e shërbimit “**Informimi i publikut për digjitalizimin**”, si dhe Lotin përkatës për të cilin oferton sipas objektit: “**Loti I Transmetimi i spotit të digjitalizimit**”, “**Loti II Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit**”, duke shënuar: “**Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertës, dhe jo para datës data 04 dhjetor 2018, ora 12.00**”.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ose dorazi para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar në adresën si më poshtë vijon:

Emri: AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
Adresa: Rr. “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë  
Tel/Fax: 04 2233006  
Adresa e Internetit: [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)  
Në emër të: Kryetarit Z. Gentian Sala  
E-mail: [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al)

**KRYETARI**  
**GENTIAN SALA**



## Shtojca 1

### DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për shkelje penale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

## Shtojca 2/ I

### FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Objekti: Loti I “Transmetimi i spoteve të digjitalizimit”

Shpeshësia (numri i Spoteve) në ditë:

Kategoritë sipas subjekteve	Spote në ditë	Nr. minimal i spoteve që mbulohen me fondin 37,525,414 lekë me TVSH për një periudhë 90 ditore	Numri i spoteve te ofruara
Televizionet kombëtare	16	1,441	
Radio kombëtare	12	1,076	
Televizionet Lokale (Tiranë)	8	717	
Televizionet Lokale	10	897	
Radio lokale (Tiranë)	10	897	
Radio lokale	8	717	
<b>Totali</b>		<b>5,745</b>	

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_



**Shtojca 2/ II**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Objekti: Loti II “Transmetimi i njoftimeve të digjitalizimit”

<b>Kategoritë sipas subjekteve</b>	<b>Nr. minimal i njoftimeve që mbulohen me fondin 1,903,586 lekë me TVSH për secilën kategori, për një periudhë 90 ditore</b>	<b>Numri i njoftimeve të ofruara</b>
Televizionet lokale	531	
Radio kombëtare	3,648	
Radio lokale	398	
<b>Totali</b>	<b>4,577</b>	

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_